



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

RAPORT MONITORIMI 6-MUJOR

JANAR-QERSHOR 2024

**ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT I
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E
JASHTME PËR PERIUDHËN**

Miratuar me Urdhër të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 150, datë 28.04.2022.

SHKURTESA DHE AKRONIME

MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
PI	Plan Integriteti
DBNJ	Drejtoria e Burimeve Njerëzore
DAHD	Drejtoria e Arkivit Historik dhe Dokumentacionit
DÇK	Drejtoria e Çështjeve Konsullore
DDPD	Drejtoria e Diplomacisë Publike dhe Diasporës
DPSH	Drejtoria e Protokollit të Shtetit
PT	Programi i Transparencës
KNJKP	Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik
KI	Koordinatori i Integritetit

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Shkurtesa dhe Ankronime.....	fq. 2
2. Përmbledhje Ekzekutive.....	fq. 4
2. Qasja metodologjike e raportit.....	fq. 6
3. Gjetjet e raportit.....	fq. 7
3.1. Objektivi 2: Përmirësimi i burimeve njerëzore duke konsoliduar një administratë në shërbimin e jashtëm, shërbimin civil dhe administratën e shërbimit jo civil, që karakterizohet nga etika dhe integriteti, duke forcuar përgjegjshmërinë në të gjitha nivelet.....	fq. 7
3.2. Objektivi 3: Përmirësimi i mekanizmave të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar, duke kontribuar në sigurimin e efikasitetit dhe në menaxhimin e burimeve publike.....	fq. 9
3.3 Objektivi 4: Përmirësimi i drejtimeve dhe ndërhyrjeve të politikave për të promovuar integritetin dhe parandaluar korrupsionin në politikën e jashtme dhe atë për Evropën e më konkretisht procesit të integritit evropian.....	fq. 10
3.4 Objektivi 5: Rritja e transparencës së punës së realizuar, politikave të hartuara dhe miratuara, angazhimeve të ndërmarra në politikën e jashtme dhe procesit të integritit evropian ndaj publikut.....	fq. 12
3.5 Objektivi 5.2 Transparenca e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve si dhe informacioni, dhe të dokumenteve elektronike.....	fq. 13
4. Konkluzione dhe rekomandime.....	fq. 15

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Integriteti është një element thelbësor që pasqyron mirëfunksionimin, mirë koordinimin dhe rrit besueshmërinë dhe forcon rolin e autoritetit publik në përgjithësi dhe në rastin konkret të MEPJ në veçanti. Ndërtimi i integritetit është sa thelbësor aq dhe jetik për një shtet të së drejtës që aspiro demokratizimin dhe që në celulën bazë ka luftën ndaj korrupsionit, parandalim të konfliktit të interesit, promovim të etikës, gjithë përfshirjen, transparencën, rritjen e efektivitetit dhe të efijencës në zbatim të detyrave dhe të ushtrimit të veprimtarisë duke u mbështetur dhe udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë. Korrupsioni, është një fenomen i kudo ndodhur shpeshherë i kamufluar dhe i vështirë për tu identifikuar, për këtë arsye merr rëndësi primare promovimi dhe zbatimi me përpikmëri i integritetit në administratën e MEPJ, përfshirë këtu nëpunësit e shërbimit të jashtëm, nëpunësit civil si dhe çdo nëpunës tjetër (marrëdhënia e punësimit e të cilit trajtohet me Kod Pune). Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre është kryer për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë sipas fushave të veprimtarisë së institucionit.

Këto fusha përfshijnë:

1. Kuadrin ligjor dhe rregullator;
2. Planifikimin strategjik dhe buxhetor;
3. Menaxhimin financiar;
4. Menaxhimin e burimeve njerëzore;
5. Kontrollin dhe auditimin;
6. Transparencën;
7. Arkivimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve shkresore si dhe të atyre elektronike;
8. Verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurave disiplinore;

Plani i integritetit për MEPJ shërben si një dokument i brendshëm me karakter udhëzues, në të cilin janë përcaktuar objektivat për forcimin e integritetit dhe etikës, që udhëheqin punonjësit gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe aktet e brendshme të MEPJ.

Ky raport është në koherencë dhe në vijim të zbatimit të Planit të Integritetit i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme 2022-2025. Raporti i monitorimit është një dokument dëftues për ecurinë e zbatimit të PI, që pas miratimit të tij në Prill të vitit 2022. Raporti përmban të dhëna për masat e caktuara për zbatim për periudhën Janar 2024-Qershor 2024, sipas objektivave përkatëse të specifikuar për afatin e zbatimit dhe njësitë përgjegjëse të angazhuara për zbatim.

Për 6-mujorin e parë të vitit 2024, PI i MEPJ-së ka të përcaktuara 27 masa nga 94 në total, të parashikuara në 4 objektiva nga 5 në total, të cilat konsistojnë si më poshtë vijon:

- **Objektivi 2:** Përmirësimi i burimeve njerëzore duke konsoliduar një administratë në shërbimin e jashtëm, shërbimin civil dhe administratën e shërbimit jovicil, që karakterizohet nga etika dhe integriteti, duke forcuar përgjegjshmërinë në të gjitha nivelet;
- **Objektivi 3:** Përmirësimi i mekanizmave të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar, duke kontribuar në sigurimin e efikasitetit dhe në menaxhimin e burimeve publik;

- **Objektivi 4:** Përmirësimi i drejtimeve dhe ndërhyrjeve të politikave për të promovuar integritetin dhe parandaluar korrupsionin në politikën e jashtme dhe atë për Evropën e më konkretisht procesit të integritetit evropian;
- **Objektivi 5:** Rritja e transparencës së punës së realizuar, politikave të hartuara dhe miratuara, angazhimeve të ndërmarra në politikën e jashtme dhe procesit të integritetit evropian ndaj publikut;

Nga procesi i monitorimit lidhur me zbatimin e masave nga njësitë përgjegjëse rezultoi se: në totalin prej 27 masash janë realizuar në masën 100%, nga të cilat një pjesë e tyre janë në vazhdimësi dhe vijohet me zbatimin e tyre me qëllim përmirësimin e klimës së punës. Këto masa apo objektiva të miratuara do të bëhen pjesë e Raportit 1-vjeçar.

Raporti për zbatimin e masave, pasqyron të dhëna konkrete për llojin e aktivitetit, që përfshin objektivin e synuar për tu arritur, masën ose aktivitetin, prioritetin, strukturën përgjegjëse dhe afatin e realizimit. Gjithashtu, përmban të dhëna të grumbulluara gjatë monitorimit të zbatimit të masës, që lidhen me hapat e ndërmarrë, dokumentet që janë hartuar/publikuar me qëllim realizimin e masës, njësinë përgjegjëse për zbatimin, nivelin në të cilin është realizuar, ndikimin që pasur realizimi i masës, problematikat që ka hasur njësitë përgjegjëse gjatë zbatimit dhe rekomandimet e saj, si dhe lloji i buxhetit të parashikuar.

Statusi i Zbatimit të Planit të Integritetit

Objektivat e PI të MEPJ për 6M1 të vitit 2024	Masat dhe aktivitetet	Realizimi i masave dhe aktiviteteve		
		Realizimi i aktiviteteve të parashikuara për 6-mujorin e parë të vitit 2024	Masa dhe aktivitete të realizuara pjesërisht	Masa dhe aktivitete të porealizuara
4 nga 5 në total	27 nga 93 në total	100%	-	-

2. QASJA METODOLOGJIKE E RAPORTIT

Për realizimin e procesit të monitorimit për 6 mujorin e parë të vitit 2024, që konkretizohet dhe materializohet nëpërmjet këtij raporti i cili do të përfshihet në hartimin e raportit përfundimtar të vitit 2024, është kryer një punë që ka konsistuar në bashkëpunimin e disa drejtorive të MEPJ-së, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, si dhe të Koordinatorit të Integritetit. Këta aktorë kanë ndërvepruar për raportimin dhe mbledhjen e informacionit mbi zbatimin e masave, është analizuar zbatimi i secilës masë, hapat e ndërmarrë, problematikat dhe rekomandimet e mundshme. Raporti përmban një analizë cilësore dhe sasiore të veprimitarisë kontribuuese të drejtorive si njësi përgjegjëse.

Të dhënat e raportuara nga drejtoritë në cilësinë e njësive përgjegjëse, janë grumbulluar dhe përpunuar nga Koordinatori i Integritetit të MEPJ-së, si personi përgjegjës për mbledhjen, analizën e informacionit dhe hartimit të raportit të monitorimit për periudhën 6-mujore.

Koordinatori i Integritetit ka koordinuar punën me sektorin e ankesave administrative dhe përfaqësimit gjyqësor për mbledhjen e informacionit, duke ju drejtuar njësive përgjegjëse në formë të shkruar apo duke zhvilluar takime në formë “*interviste*” për të pasur informacion të detajuar mbi nivelin e zbatimit të masave dhe verifikueshmërinë e tyre. Është vijuar me sistemimin e të dhënave për pasqyrimin sa më saktë dhe real në këtë raport, përdorimin e një gjuhe sa formale edhe të thjeshtë, që të jetë i kuptueshëm edhe për publikun, për shkak se ky raport monitorimi 6 mujor do të bëhet pjesë e Raportimit Vjetor të PI-së dhe do të publikohet në programin e transparencës, në faqen zyrtare të MEPJ për vitin 2024.

Njësitë përgjegjëse, të cilat kanë raportuar për zbatimin e masave për këtë periudhë 6 (gjashtë) mujore janë si më poshtë:

1. *Drejtoria e Burimeve Njerëzore;*
2. *Drejtoria e Diplomacisë Ekonomike;*
3. *Koordinatori për të Drejtën e Informimit;*
4. *Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik;*
5. *Drejtoria e Çështjeve Konsullore;*
6. *Drejtoria e Amerikave, Azisë dhe Afrikës;*
7. *Drejtoria e NATO-s*
8. *Drejtoria e Financës dhe Menaxhimit Financiar;*
9. *Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme.*

Njësitë e lartpërmendura kanë raportuar te Koordinatorin i Integritetit. Kontributi i tyre shtrihet në drejtim të nivelit të zbatimit të masës përkatëse, aktet e publikuara, takimet, hapat e ndërmarrë, të dhënat për buxhetin, problematikat dhe rekomandimet e mundshme.

Raporti për këtë periudhë është hartuar duke u bazuar në analizën e të dhënave që drejtoritë/personat përgjegjës kanë raportuar, si në aspektin cilësor por dhe atë sasior. Konkretisht, analiza cilësore konsiston në vlerësimin e zbatimit të masave sipas drejtimit të tyre dhe fushës/objektivave të synuara, ndërsa analiza sasiore është kryer bazuar në të dhënat statistikore.

3. GJETJET E RAPORTIT

3.1 . Objektivi 2: Përmirësimi i burimeve njerëzore duke konsoliduar një administratë në shërbimin e jashtëm, shërbimin civil dhe administratën e shërbimit jo civil, që karakterizohet nga etika dhe integriteti, duke forcuar përgjegjshmërinë në të gjitha nivelet.

Ky objektivi thekson domosdoshmërinë e përmirësimit të burimeve njerëzore në vazhdimësi ku përmes këtij objektivi synohet të arrihet përfundimi si dhe përmirësimi i burimeve njerëzore të MEPJ-së, në të gjithë kategoritë e burimeve njerëzore duke përfshirë, nëpunësit e shërbimit të jashtëm, nëpunësit e shërbimit civil si dhe të shërbimit teknik. Etika dhe integriteti përgjithësisht konsistojnë në zbatimin e vlerave thelbësore dhe standardeve të larta të sjelljes nga zyrtarët publik.

Krijimi i një kulture, integriteti, mund të jetë i vështirë për shkak të lidhjes së dyanshme mes autoritetit shtetëror dhe pushtetit në vendimmarrje, që jepen në ushtrimin e funksioneve publike, gjë që do të thotë që mundësitë dhe stimujt për përfitime të paligjshme mund të jenë të shumta.

Kështu, edhe konsolidimi dhe forcimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në ministri, si për kategorinë e nëpunësve të shërbimit të jashtëm, si për të shërbimit civil, apo edhe të kategorisë së shërbimit teknik dhe të mirëmbajtjes, është shumë i rëndësishëm për të pasur një administratë publike efikase, transparente, të përgjegjshme dhe të pakorruptuar në të gjitha nivelet.

Për periudhën e monitorimit Janar 2024-Qershor 2024, për përmbushjen e objektivit të sipërcituar, janë përcaktuar për zbatim 27 masa/aktivitete nga njësitë e përcaktuara për të cilat janë investuar dhe kanë vijuar me zbatimin e tyre për përmirësimin e klimës së punës në tërësi.

Njësitë përgjegjëse/raportuese për përmbushjen e këtij objektivi janë: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Drejtoria e NATO-s, Drejtoria e Diplomacisë Ekonomike, Drejtoria e Arkivit Historik dhe Dokumentacionit, Drejtoria e Amerikave, Azisë dhe Afrikës, Drejtoria e Çështjeve Konsullore, të cilat kanë realizuar masat në nivelet e treguara si në tabelën e mëposhtme:

Objektivi 2	Masat dhe aktivitetet	Realizimi i masave dhe aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për 6-mujorin e parë të vitit 2024	Masa dhe aktivitete të realizuara plotësisht	Masa dhe aktivitete të realizuara pjesërisht	Masa dhe aktivitete të porealizuara
Përmirësimi i burimeve njerëzore duke konsoliduar një administratë në shërbimin e jashtëm, shërbimin civil dhe administratën e shërbimit jo civil, që karakterizohet nga	Masa dhe aktivitete	10	10	-	-

etika dhe integriteti, duke forcuar përgjegjshmëritë në të gjitha nivelet.					
--	--	--	--	--	--

2.1 Vonesa në procesin e popullimit të sistemimit të informacionit të menaxhimit të burimeve njerëzore (HRMIS) me të dhënat për të gjitha Burimet njerëzore.

HRMIS plotësohet rast pas rasti. Për shkak të ndryshimeve në pozicionet e punës së diplomatëve është gjithmonë në proces azhurnimi.

DBNJ ka të gjitha databazat të MEPJ dhe të Përfaqësive me të dhënat e stafit, të cilat i përditëson në çdo rast që ka ndryshime.

Në Kartotekën e DBNJ administrohen Dosjet e personelit të cilat janë plotësuar për secilin punonjës të shërbimit të jashtëm.

2.2 Vonesa në procesin e komunikimit të brendshëm ndërmjet drejtorive të ministrisë, ose/dhe me agjencitë e varësisë dhe aktorëve të tjerë të interesit

Është një çështje që ka nisur dhe është në proces shqyrtimi, por që kërkon angazhimin e të gjitha njësive organizative të MEPJ.

Për momentin, struktura trajnuese e MEPJ - Akademia Diplomatike mbështetet në veprimtarinë e saj në Ligjin nr. 23/2015 "Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë", Neni 36, dhe VKM Nr.816, datë 07.10.2015 "Për miratimin e Rregullores së Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë", nga ku organizon trajnimin e detyrueshëm pranë strukturave të MPJ-së për një periudhë tremujore të kandidatit për t'u pranuar në Shërbimin e Jashtëm, si edhe atë të thelluar për diplomatët, në fushën ku janë vërejtur mangësitë.

2.3 Njohuri teknike të kufizuara veçanërisht për punonjësit e përfaqësive diplomatike për aktivet e institucionit dhe përgatitjen e bilancit.

Nga ana e Drejtorisë Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar është raportuar se ky rekomandim është në proces zbatimi. Kështu, gjatë vitit 2023 strukturat e DBMF kanë ofruar trajnim për Titullarët e përfaqësive që u Dekretuan.

2.4 Mungesa e trajnimeve profesionale për punonjësit e Drejtorisë së Amerikave, Azisë, dhe Afrikës (DAAA), në përputhje me politikat e institucionit dhe zhvillimeve të fundit gjeostrategjike

Drejtoria e Amerikave, Azisë dhe Afrikës si instanca kompetente në bashkëpunim me DBNJ kanë vijuar me marrjen e masave për zbatimin e këtij rekomandimi dhe konkretisht: Diplomati Shkëlzen Logu mori pjesë në trajnimin e MPJ të Italisë dhe EUI/STG me temë: Capacity Building Programme for Junior-Career Diplomats of the EB Global Challenges and EU Policymaking June 2024 Florence School of Transnational Governance. Pra, është ofruar një trajnim me qëllim këshillimin e specialistëve të sektorit për mirëfunksionimin e punës.

2.5 Njohje e kufizuar e punonjësve të ministrisë për procedurat e prokurimeve publike në ministri.

Sektori i Prokurimeve Publike ka marrë në konsideratë zbatimin e PI-së dhe i ka vendosur si prioritet për t'i zbatuar ato në praktikë me qëllim njohjen nga më gjerë të tyre nga punonjësit e tjerë.

Në kuadër të procedurave të prokurimit publik për blerjet protokollare është ngritur Komision i Përherëshëm për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbime apo punëve publike nga punonjës të drejtorive të ndryshme të MEPJ.

2.6 Njohuri teknike të kufizuara për punonjësit e DPA-së për shkak të mungesës së trajnimeve dhe përfshirjes së tyre si këshillues praktikë në proces.

Për një planifikim, ose orientim programor, më 14.11.2023, AD, përmes SP ka shpërndarë për drejtuesit e MEPJ, një qarkore me kërkesë kryesore evidentimin dhe vlerësimin e kapaciteteve të tanishme, dhe, mbi këtë bazë, të mund të përcaktojnë (nëse ka) ndonjë mangësi dhe/ose kërkesë për përmirësim të mëtejshëm të aftësisë profesionale, qofshin të rrafshit diplomatik, apo të llojit organizativ/ administrativ.

2.7 Bashkëpunim i kufizuar mes Sektorit të Ankesave Administrative dhe Përfaqësimit Gjyqësor dhe drejtorive të ministrisë në procesin e mbledhjes së provave brenda afateve ligjore në kuadër proceseve gjyqësore ku ministria është palë.

Spektori i Ankesave Administrative dhe Përfaqësimit Gjyqësor bashkëpunon mënyrë të vazhdueshme me drejtoritë e tjera sa herë që lind nevoja për të mbledhur prova të cilat shërbejnë për ndjekjen e proceseve gjyqësore.

2.8 Njohuri të kufizuara të Sektorit të Ankesave Administrative dhe Përfaqësimit Gjyqësor për të drejtën procedurale të aplikuar.

Akademia Diplomatike, si strukturë trajnuese ka nisur prej kohësh bashkëpunimin ndër-institucional me struktura trajnuese, për çështje përtej marrëdhënieve ndërkombëtare/diplomacisë, si për shembull ASPA dhe do të shqyrtojë/përcjellë kërkesën për një trajnim të tillë.

2.9 Bashkëpunimi i kufizuar ndër sektorial brenda ministrisë në Sektorin e Ankesave Administrative dhe Përfaqësimit Gjyqësor në kuadër të procesit të rishikimit të CPS-së për punonjësit e ministrisë.

Mbi realizimin e këtij objekti është vijuar me hartimin e një Urdhri mbi informimin e punonjësve të rinj të cilët kur paraqiten në punë për herë të parë apo kur emërohen si nëpunës/punonjës pranë MEPJ duhet të pajisen me CSP.

2.10 Mungesa e PSV-je për lëvizjet jashtë qytetit dhe jashtë vendit të personelit të ministrisë (Kryesisht procedura e blerjeve të biletave të avionit).

Përsa i përket kësaj pike e cila është me një masë me nivel mesatar është vijuar me procedurat për shërbimet brenda dhe jashtë vendit janë unifikuar dhe miratuar nga titullari i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

3.2. Objektivi 3: Përmirësimi i mekanizmave të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar, duke kontribuar në sigurimin e efikasitetit dhe në menaxhimin e burimeve publike.

Një komponent i rëndësishëm për një administratë publike efektive është promovimi i planifikimit racional dhe monitorimi efektiv i aktiviteteve të saj. E ndaj në promovim të këtij efikasiteti ministria angazhohet të hartojë, zbatojë, monitorojë mekanizma efektivë kontrolli.

Ky objektiv ka në total 1 masë për tu realizuar për periudhën raport monitorimi Janar-Qershor 2024.

Për sa më sipër masat reflektohen ne tabelën e mëposhtme në zbatim të këtij objektivi.

Objektivi 3	Masat dhe aktivitetet	Realizimi i masave dhe aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për periudhën 6M1 Janar-Qershor 2024	Masa dhe aktivitete të realizuara plotësisht	Masa dhe aktivitete të realizuara pjesërisht	Masa dhe aktivitete të porealizuara
Përmirësimi i mekanizmave të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar, duke kontribuar në sigurimin e efikasitetit dhe në menaxhimin e burimeve publike	Masa/aktivitete	1	100%	-	-

3.1 Mungesë e veprimtarive/kalendari eventesh me karakter social në ambasada.

Si një objektiv i vendosur me prioritet mesatar DBNJ ka vijuar me hartimin e një plani i cili nuk është finalizuar në të cilin janë përfshirë takime socializimi në ambasada dhe konsullata.

3.3 Objektivi 4: Përmirësimi i drejtimeve dhe ndërhyrjeve të politikave për të promovuar integritetin dhe parandaluar korrupsionin në politikën e jashtme dhe atë për Evropën e më konkretisht procesit të integritetit evropian.

Objektiv final i këtij plani integriteti kundër korrupsionit është krijimi, forcimi dhe mbështetja e një kulture integriteti të inkorporuar në të gjithë institucionin. Ky objektiv ka 6 masa. Më konkretisht;

Objektivi 4	Masat dhe aktivitetet	Realizimi i masave dhe aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për periudhën	Masa dhe aktivitete të realizuar	Masa dhe aktivitete të realizu	Masa dhe aktivitete të porealizuara

		6M1 Janar-Qershor 2024	a plotësisht	ara pjesërisht	
Përmirësimi i drejtimeve dhe ndërhyrjeve të politikave për të promovuar integritetin dhe parandaluar korrupsionin në politikën e jashtme dhe atë për Evropën e më konkretisht procesit të integritetit evropian	Masa/aktivitete	5	5	-	-

4.1 Mungesa e PSV-së për legalizimet

Nga Drejtoria e Çështjeve Konsullor është raportuar se mbi këtë objektiv me prioritet mestar ka nisur procedura për rishikimin e kontratës me Postën Shqiptare për të reflektuar rekomandimet e KLSH.

4.2 Ndërveprim i kufizuar i Drejtorisë së Protokollit të Shtetit dhe drejtorive të tjera të ministrisë në kuadër të proceseve të punës që realizohen në bashkëpunim.

Në lidhje me këtë masë është vijuar marrja në konsideratë duke u bashkërenduar me drejtoritë e tjera me qëllim lehtësimin e punës. Konkretisht DPSHP ka vijuar me takime të përbashkëta pune mbi politikat konkrete.

4.3 Strategjia ndërinstytucionale për zhvillim dhe veprim në kuadër të diplomacisë ekonomike nuk është zhvilluar.

Hartimi i një strategjie për diplomacinë ekonomike duket me interes, or vlerësoj se kjo pike ka nevojë të elaborohet më konkretisht me ekspertët e fushës, dhe do një konsultim më të gjerë se vet MEPJ.

MEPJ ne kuadër te diplomacisë ekonomike e gjen veten te involvuar ne strategji të tjera sektoriale të cilat e lidhin atë (MEPJ) në kuadër të aktiviteteve që i dedikohen promovimit, nxitjes dhe tërheqjes së investimeve dhe mbështetjes se biznesit. Nuk mendoj se është momenti qe MEPJ me kaq fushe veprimi qe ka, ku politika ekonomike, tregtare, fiskale, financiare përpilohen, zbatohen, monitorohen dhe raportohen diku tjetër, ku agjencitë ekzistuese për sa me sipër ose janë në varësi të KM ose të MEKI-t ose të MTM-së, me strukturën zbatuese të saj (mungojnë atashetë tregtare/ ekonomike) dhe buxhetin aktual në dispozicion të krijojë një strategji të sajën për diplomacinë ekonomike.

4.4 Mungesë e një PSV-je për trajtimin e çështjeve nga Drejtoria e Diplomacisë Ekonomike

Drejtoria e Diplomacisë Ekonomike ka krijuar dhe plotëson dy PSV për trajtimin e çështjeve qe përpunon ne veprimtarinë e saj te përditshme, një PSV të brendshme për praktikat që adresohen tek drejtoritë e tjera të tutelës në MEPJ dhe një tjetër PSV për shkresat që i adresohen/delegohen/

ngarkohen Drejtorisë së Diplomacisë Ekonomike, te cilat pasi përgatiten/përpunohen regjistrohen dhe përcillen në strukturën vertikale për të ndjekur më pas rrugën e tyre drejt destinacionit final.

4.5 Rregullat e përgatitjes së dosjes për takimet e larta në NATO nuk janë të formalizuara.

Dosjet e takimeve të nivelit të lartë të NATO-s përgatiten sipas strukturës e formatit të përcaktuar nga MEPJ. Kjo është pasqyruar edhe në dosjen e përgatitur me rastin e pjesëmarrjes së Shqipërisë/KM në Samitin e Uashingtonit, 9-11 korrik 2024.

Pavarësisht nivelit të klasifikimit, struktura dhe formati i dosjeve të NATO-s nuk kërkon ndonjë akt të posaçëm formalizues.

3.4 Objektivi 5: Rritja e transparencës së punës së realizuar, politikave të hartuara dhe miratuara, angazhimeve të ndërmarra në politikën e jashtme dhe procesit të integritetit evropian ndaj publikut.

Objektivi i transparencës synon pasqyrimin e informacioneve të plota për implikimet e ministrisë në procesin e vendimmarrjes. Publikimi dhe transparenca u mundëson aktorëve të interesuar dhe qytetarëve veçanërisht aksesimin e informacionit.

Nga monitorimi, niveli i zbatimit të masave nga strukturat përgjegjëse, rezulton si në tabelën e mëposhtme:

Objektivi 5	Masat dhe aktivitetet	Realizimi i masave dhe aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për periduhën 6M1 janar-qershor 2024	Masa dhe aktivitete të realizuara plotësisht	Masa dhe aktivitete të realizuara pjesërisht	Masa dhe aktivitete të parealizuara
Transparenca e MEPJ	Masa/aktivitete	5	5	-	-

5.1 Informim i kufizuar i personelit të ministrisë për detyrimet e përmirësimit të PT-së për ministrinë

Koordinatori për të Drejtën e Informimit ndjek të gjitha detyrat ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Gjithashtu asiston në përditësimin e programit të Transparencës të institucionit që publikohet në faqen zyrtare të tij.

5.2 Mangësi në procesin e plotësimit të regjistrit të kërkesave dhe realizimit të tyre.

Regjistri i kërkesave publikohet periodikisht në programin e transparenës në faqen Eeb të Ministrisë çdo 1 muaj nga 3 muaj që ishte më parë.

5.3 Mungesë e publikimit të raporteve për projekt aktet në faqen zyrtare të ministrisë dhe të regjistrin të konsultimit publik.

Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik si njësi përgjegjëse ka raportuar se është mas që publikohet në vazhdimësi. Publikimi i raportit 6 mujor të konsultimit publik bëhet brenda datës 25 korrik në faqen zyrtare të ministrisë, ndërkohë që raporti vjetor publikohet brenda datës 31 janar, pas miratimit të tyre nga Kryeministria.

5.4 Njohuri të kufizuara për punonjësit e ministrisë për legjislacionin e informimit dhe kufizimet e tij përfshirë edhe të dhënat personale.

Në lidhje me këtë objektiv Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka informuar të gjithë punonjësit e MEPJ duke filluar me trajnimet e organizuara në institucion dhe ato të ofruara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).

5.5 Mungesë e Publikimit të Raportit Vjetor të Transparencës.

Njësia përgjegjëse, Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik ka raportuar se në faqen zyrtare të ministrisë publikohen raporti 6-mujor dhe raporti vjetor i konsultimit publik, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik

3.4 Objektiv 5.2: Transparenca e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve si dhe informacioni, dhe të dokumenteve elektronike.

Objektivi i transparencës synon pasqyrimin e informacioneve të plota për implikimet e ministrisë në procesin e vendimmarrjes. Publikimi dhe transparenca u mundëson aktorëve të interesuar dhe qytetarëve veçanërisht aksesimin e informacionit në mënyrë elektronike.

Nga monitorimi, niveli i zbatimit të masave nga strukturat përgjegjëse, rezulton si në tabelën e mëposhtme:

Objektivi 5	Masat dhe aktivitetet	Realizimi i masave dhe aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023	Masa dhe aktivitete të realizuara plotësisht	Masa dhe aktivitete të realizuara pjesërisht	Masa dhe aktivitete të porealizuara
Transparenca e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve si dhe informacioni, dhe të dokumenteve elektronike	Masa/aktivitete	6	6	-	-

5.2.1 Mangësi në njohjen e kuadrit rregullator të arkivave të dokumentimit historik.

Pavarësisht se në Planin e Integritetit të MEPJ përshkruhet si çështje për zbatim nga Drejtoria e Arkivit Historik dhe Dokumentacionit, kjo praktikë aktualisht ndiqet nga Drejtoria e Sekretarisë dhe Komunikimit Qendror, e cila mbulon edhe procesin e para-arkivimit të dokumentacionit. Në DAHD përcillet vetëm dokumentacioni me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK).

5.2.2 Punonjësit e përfaqësive diplomatike kanë mangësi në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit për arkivat dhe dokumentacionin

Në mënyrë periodike, DAHD i pajis/ridërgon punonjësit e përfaqësive diplomatike me “Rregulloren për punën me dokumentet dhe arkivat në përfaqësitë diplomatike e konsullore të Republikës së Shqipërisë” dhe “Skemën e Indeksimit dhe Ekspertizës së Dokumenteve”, të cilat shërbejnë në formë udhëzuesi për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit për arkivat dhe dokumentacionin. Dërgimi i fundit i këtij informacioni për të gjitha Përfaqësitë e RSh është bërë në janar të vitit 2024.

5.2.3 Përfaqësitë diplomatike nuk dorëzojnë dokumentacionin pranë Drejtorisë së Arkivit Historik dhe Dokumentacionit

Aktualisht, përveç Përfaqësive të cilat e kanë dorëzuar në mënyrë të rregullt Dokumentacionin e kontrolluar periodikisht nga DAHD, janë dhe disa Përfaqësi, të cilat pavarësisht komunikimeve me Drejtorinë, nuk e kanë dorëzuar dokumentacionin e kontrolluar nga DAHD, edhe pas dy kontrollesh rradhazi, duke sjellë mbingarkesë në Arkivin e tyre, por edhe bashkim të dokumentacionit të kontrolluar një herë, me dokumentacionin e krijuar rishtaz. Mendojmë që në këto raste është shpenzim i pajustificuar vajtja e specialistëve të DAHD për të kontrolluar atë që është kontrolluar një apo më shumë herë.

5.2.4 Modelet e shkresave dhe përditësimet e tyre nuk janë lehtësisht të aksesueshme nga punonjësit e ministrisë.

Pavarësisht se në Planin e Integritetit të MEPJ përshkruhet si çështje për zbatim nga Drejtoria e Arkivit Historik dhe Dokumentacionit, kjo praktikë aktualisht ndiqet nga Drejtoria e Sekretarisë dhe Komunikimit Qendror.

5.2.5 Mungesa e një arkivi digjital për fondin e Arkivit Historik.

Në funksion të zbatimit të këtij rekomandimi MEPJ ka paraqitur kërkesë për fonde shtesë në dokumentin e PBA 2025-2027 për të mundësuar blerjen e aparaturave specifike për krijimin e fondit dixhital.

5.2.6 Mungesë e rregullore për menaxhimin e rekordeve të dosjes

Pavarësisht se në Planin e Integritetit të MEPJ përshkruhet si çështje për zbatim nga Drejtoria e Arkivit Historik dhe Dokumentacionit, kjo praktikë aktualisht ndiqet nga Drejtoria e Sekretarisë dhe Komunikimit Qendror e cila është marr në konsideratë dhe zbatuar.

3 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Ky raport për 6M1 për periudhën Janar-Qershor 2024 dëshmon monitorimin dhe respektimin e zbatimit të Planit të Integritetit nga strukturat përgjegjëse në MEPJ. Kjo periudhë raportimi konsiston në përkushtim të strukturave të përfshira, bashkëpunim dhe rakordim ndërmjet drejtorive duke bërë të mundur që për këtë periudhë raportimi të realizohen në masën 100%. Gjithashtu, pritet të finalizohet procesi i strukturës i MEPJ ku do të përcaktohen qartësisht strukturat e çdo drejtorie.

Në përfundim të gjithë sa më sipër kemi konstatuar, trajtuar dhe analizuar, rezulton se për **periudhën 6M1 Janar-Qershor 2024:**

- *MEPJ është angazhuar në zbatim të planit të integritetit;*
- *Në kuadër të zbatimit të PI, strukturat përgjegjëse kanë vepruar me qëllim realizimin e masave përkatëse me përgjegjshmëri;*
- *Rol të rëndësishëm ka pasur Drejtoria e Burimeve Njerëzore e cila njëkohësisht ka vëllimin më të madh si njësi përgjegjëse.*
- *Rritur performanca e burimeve njerëzore në të gjitha nivelet, janë kryer trajnime si për të drejtën e informimit, për mbrojtjen e të dhënave personale, për CSP etj., janë informuar punonjësit për detyrat e tyre, është hartuar Kodi i Etikës, në proces rishikimi, është përditësuar baza e të dhënave për çdo diplomat;*
- *Është realizuar detyrimi për të pasur një administratë transparente në veprimtari dhe vendimmarrje, nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve për rolin e Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, si dhe të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.*
- *Është garantuar transparencë e plotë dhe ofrim të informacioneve mbi aktivitetin e ministrisë për publikun e gjerë nëpërmjet faqes së internetit <https://punetejashtme.gov.al/programi-i-transparences/>.*

Në vazhdimësi rekomandojmë:

- *Të vijohet me zbatimin e parashikimeve të planit të veprimit, plotësimin e masave që janë ende në proces me qëllim që të shtohen në raportimin vjetor.*
- *Të vijohet me zbatimin dhe me garantimin në vazhdimësi të transparencës.*